



Nëntor 2022

Tashmë ka filluar numërimi mbrapsht për Konferencën dhe Ekspozitën e 10-të të Përbashkët Ballkanike!



Trajnimet dhe programet e ardhshme të zhvillimit të kapaciteteve

[Hyrje në Sistemet e Kanalizimeve dhe Ujërave të Ndotura për Menaxherët dhe Inxhinierët, Trajnimi “Menaxhimi i Projekteve Infrastrukturore”](#)
9-10 Nëntor 2022

[Siguria në Punë për Profesionistët e Ujërave të Ndotura](#)
23-24 Nëntor 2022, Tirana

Konferencat e Ardhshme Ndërkombëtare

[Konferenca e 17-të e EWA Hibrade e Brukselit](#)

Vivaqua, Bruksel
8 Nëntor 2022

UJËRAT NËNTOKËSORË TË BËJMË TË PADUKSHMEN TË DUKSHME

KONFERENCA DHE EKSPOZITA
E PËRBASHKËT BALLKANIKE
8-10 NËNTOR 2022
PRISHTINË, KOSOVË



Konferenca dhe Ekspozita e 10-të e Përbashkët Ballkanike, **“Ujërat nëntokësorë – Të bëjmë të padukshmen të dukshme”**, që do të mbahet **më 8-10 nëntor 2022, në Hotel Emerald, Prishtinë**, është vetëm disa ditë larg.

Komiteti Organizativ dhe i Programit kanë kënaqësinë të ndajnë disa nga pikat kryesore të eventit.

Vendimarrës të niveli të lartë



H.T. Getoar Mjeku, Zëvendës Ministër, Ministria e Ekonomisë, Kosovë , do të mbajë një fjalim përshëndetës gjatë Ceremonisë së Hapjes së Konferencës më 8 nëntor 2022, si dhe në hapjen e ditës së dytë të punës së sesioneve të Konferencës, më 10 nëntor 2022.



SH.S. Linda Çavdarbasha, Zëvendës Ministër, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktura, Kosovë, do të mbajë një fjalim përshëndetës gjatë Ceremonisë së Hapjes së Konferencës më 8 nëntor 2022, si dhe në hapjen e ditës së parë të punës së sesioneve të Konferencës, më 9 nëntor 2022.

[lexo më shumë](#)

Çfarë ka të re në SHUKALB!

SHUKALB zhvillon me sukses trajnimin 3-ditor me temë “Teknologjitë”



Në datat 12-14 tetor 2022, në Tiranë, SHUKALB zhvilloi me sukses trajnimin 3-ditor me temë “Teknologjitë”, në kuadër të Programit të RCDN të Zhvillimit të Kapaciteteve “Hyrje në Sistemet e Kanalizimeve dhe Trajtimin të Ujërave të Ndotur për Menaxherët dhe Inxhinierët”, i cili pilotohet për herë të parë në kuadër të Projektit “Rrjeti Rajonal për Zhvillimin e Kapaciteteve për Shërbimet e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve (RCDN)”.

Në trajnim morën pjesë përfaqësues nga Shoqëritë UK Vlorë, Shkodër, Lezhë, Kamëz, Fier dhe Himarë, si dhe Bashkitë Vlorë dhe Lezhë. Trajnimi drejtohet nga Prof. Enkelejda Gjinali, Lektore, Universiteti Politeknik i Tiranës, Ing. Enkeleda Basha, Menaxhere e Impiantit të Trajtimin të Ujit të Ndotur Durrës dhe Ing. Blerina Arrtunda, Menaxhere e Impiantit të Trajtimin të Ujit të Ndotur Shirokë dhe Velipojë, ShaUK Shkodër. [lexo më](#)

[shumë](#)

Lajme nga anëtarët tanë

[Samiti Dixhital i Ujit](#)

Bilbao, Spanjë
29 Nëntor – 2 Dhjetor 2022

Bashkohuni me Ne!



Na tregoni se çfarë mendoni!



Rreth SHUKALB

Shoqata Ujës-jellës Kanalizime e Shqipërisë (SHUKALB), e themeluar në vitin 2000, është një Shoqatë profesionale, jofitimprurëse e profesionistëve në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, e cila synon të

Praktikat më të mira për programin e riparimit dhe zëvendësimit të tubacioneve



Për nga natyra që kanë, çarjet e tubacioneve të ujit janë defekte që nuk parashikohen dot. Ekipet e punës hidhen në veprim dhe e zgjidhin problemin sa më shpejt që të jetë e mundur për të zbutur dëmet. Si në çdo emergjencë, shpejtësia e

zgjidhjes është shpesh më e rëndësishme se kostoja. Ndërmarrjet janë të gatshme që t'i heqin punonjësit nga punët e tjera që u janë ngarkuar, të paguajnë qira për pajisje të shtrenjta, të paguajnë tarifa të larta për ata që ua sjellin ato pajisje e kështu me radhë. Nga ana tjetër, zëvendësimi i infrastrukturës së vjetër shpesh të shpërblehet duke të dhënë më shumë kohë, kohë që ndërmarrjet mund ta shfrytëzojnë për të punësuar ekspertë që mund të bëjnë një vlerësim të situatës, për të gjetur zgjidhjen më të mirë dhe për t'u dhënë së pari prioritet nevojave më të rëndësishme.

Megjithëse mund të mos e dish saktësisht se kur dhe ku do të shpërthejë tubacioni i radhës, ti prapëseprapë mundesh të bësh një planifikim për këto raste dhe të gjitha përpjekjet që do të bësh për këtë qëllim do të të shpërblehen duke zbatuar projektet më të mira për zëvendësimin e tubacioneve aty ku duhet. Më poshtë janë disa nga praktikat më të mira që përdorin ndërmarrjet për trajtimin e problemeve historike që po konsumojnë buxhetet sot. [lexo më shumë](#)

Të tjera

Marrëveshja e Gjellbër Evropiane: Komisioni propozon rregulla për ajër dhe ujë më të pastër

Sot Komisioni po propozon rregulla më të forta për ajrin e ambientit, ndotësit e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe trajtimin e ujërave të ndotura urbane. Në të gjithë ajrin dhe ujin, rregullat e reja sigurojnë kthim të qartë të investimit falë përfitimeve në shëndet, kursime të energjisë, prodhimin e ushqimit, industrinë dhe biodiversitetin. Duke nxjerrë mësimet nga ligjet aktuale, Komisioni propozon të shtrëngohen nivelet e lejuara të ndotësve dhe të përmirësohet zbatimi për të siguruar që qëllimet e reduktimit të ndotjes të arrihen më shpesh në praktikë.

Komisioneri për Mjedisin, Oqeanet dhe Peshkimin, Virginijus Sinkevičius, tha: *“Cilësia e ajrit që thithim dhe e ujit që përdorim është thelbësore për jetën tonë dhe të ardhmen e shoqërive tona. Ajri dhe uji i ndotur dëmtojnë shëndetin tonë,*

përmirësojë menaxhimin e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve në Shqipëri, për ta bërë atë më eficient, të qëndrueshëm dhe efektiv në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi në Shqipëri.

ekonominë tonë dhe mjedisin, duke prekur më së shumti grupet e cenueshme. Prandaj është detyra jonë të pastrojmë ajrin dhe ujin për brezat tanë dhe për brezat e ardhshëm. Kostoja e mosveprimit është shumë më e madhe se kostoja e parandalimit. Kjo është arsyeja pse Komisioni po vepron tani për të siguruar veprime të koordinuara në të gjithë Bashkimin për të trajtuar më mirë ndotjen në burim – në nivel lokal dhe ndërkufitar.[lexo më shumë](#)

[Anëtarësohuni në SHUKALB](#)

[Kursët e Trajnimit](#)

[Na kontaktoni](#)

Shoqata Ujësjiellës Kanalizime e Shqipërisë,

Rruga "Pjeter Bogdani", 39/1, k5, 3, Njësia Bashkiake Nr. 5, Kodi Postar 1019, Tirane, Shqiperi

Tel/Fax: (+355/4) 2245 101, Mob: (+355) 69 60 12 782

E-mail: info@shukalb.al, **Web:** www.shukalb.al

Çregjistrohu

Unsubscribe